




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, neni 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), neni 17 paragrafi 1, shkronja g) dhe neni 40 paragrafi 1 dhe 2 shkronja l), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, konform Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera, ndërlidhur me nenin 90 paragrafi 1 dhe 3, të Ligjit Nr.04/L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera, dhe neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 07.04.2026, miratoi kë

V E N D I M

(Për miratimin e raportit përfundimtar Nr. 06-325/04-0011275/26, i datës; 30.03.2026 të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në Infrastrukturë Publike nga vërshimet dhe fatkeqësitë tjera natyrore për muajit janar 2026)

Neni 1

Miratohet propozim-vendimi me Nr.02-325/04-0011501/26, i datës; 31.03.2026, Për miratimin e raportit përfundimtar Nr. 06-325/04-0011275/26, i datës; 30.03.2026, i hartuar nga komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe fatkeqësitë tjera natyrore, në Infrastrukturë Publike për muajit Janar 2026 në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale prej **2,014,930.00 Euro** .

Neni 2

Me miratimin e këtij vendimi, miratohet raporti përfundimtar i dëmeve i cekur në nenin 1, i shqyrtuar nga kryetari i komunës, përmban një vlerësim profesional nga të dhënat e evidentuara dhe të regjistruara nga dalja në vend shikim të komisionit paraprak të emëruar nga kryetari i komunës dhe kërkesave për kompensim të dëmeve nga qytetarët e dëmtuara nga vërshimet, dëme të shkaktuara në Infrastrukturë Publike, të cekura në nenin një, dhe i njëjti raport me miratimin në kuvendin komunal në afat prej 30 ditëve nga dita e miratimit i dorëzohet Agjencisë së menaxhimit emergjent, dhe një kopje të njëjtësuar Komisionit Qendror të themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 3

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë: Kryetari i Komunës, në bashkëpunim me Komisionin Profesional Komunal mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe fatkeqësitë tjera natyrore.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 30 dite pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb-faqen e komunës.

Bashkëngjitur: Raporti përfundimtar Nr. 06-325/04-0011275/26, i datës; 30.03.2026, Tabela e dëmeve në Infrastrukturë Publike dhe vendimi për themelimin e Komisionit Komunal Nr. 02-020/01-0000935/26, i datës; 08.01.2026.


Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Arkivit;
- 1x1 Zyrës së Kryetarit;
- 1x1 AME-së;
- 1x1 MAPL-së;
- 1x1 Dosjes.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, neni 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), neni 17 paragrafi 1, shkronja g) dhe neni 40 paragrafi 1 dhe 2 shkronja l), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, konform Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera, ndërlidhur me nenin 90 paragrafi 1 dhe 3, të Ligjit Nr.04/L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera, dhe neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 07.04.2026, miratoi kë

V E N D I M

(Për miratimin e raportit përfundimtar Nr. 09-020/01-0010900/26, i datës; 26.03.2026 të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe fatkeqësitë tjera natyrore për muajt janar 2026)

Neni 1

Miratohet propozim-vendimi me Nr.02-052/01-0011447/26, i datës; 30.03.2026, Për miratimin e raportit përfundimtar, Nr. 09-020/01-0010900/26, i datës; 26.03.2026 , i hartuar nga komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe fatkeqësitë tjera natyrore për muajt Janar 2026, Dëmet janë shkaktuar në bujqësi, ekonomi familjare, biznese dhe vetura, në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale prej **532,666.96 Euro** .

Neni 2

Me miratimin e këtij vendimi, miratohet raporti përfundimtar i dëmeve i cekur në nenin 1, i shqyrtuar nga kryetari i komunës, përmban një vlerësim profesional nga të dhënat e evidentuara dhe të regjistruara nga dalja në vend shikim të komisionit paraprak të emëruar nga kryetari i komunës dhe kërkesave për kompensim të dëmeve nga qytetarët (familjet) e dëmtuara nga vërshimet , të cekura në nenin një, dhe i njëjti raport me miratimin në kuvendin komunal në afat prej 30 ditëve nga dita e miratimit i dorëzohet Agjencisë së menaxhimit emergjent, dhe një kopje të njëjtësuar Komisionit Qendror të themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 3

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë: Kryetari i Komunës, në bashkëpunim me Komisionin Profesional Komunal mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe fatkeqësitë tjera natyrore.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 30 dite pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb-faqen e komunës.

Bashkëngjitur: Raporti përfundimtar Nr. 09-020/01-0010900/26, i datës; 26.03.2026, Lista e dëmeve të ekonomive familjare të vlerësuar nga komisioni komunal, Lista e fermerëve të vlerësuar nga komisioni komunal, Lista e bizneseve dhe veturave të vlerësuar nga komisioni komunal dhe vendimi bazë i komisioni komunal nr. 02-020/01-0000931/26 të datës; 08.01.2026 i plotësuar dhe ndryshuar me vendim nr. 02-020/01-0004062/26, të datës; 28.01.2026.


Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Arkivit;
- 1x1 Zyrës së Kryetarit;
- 1x1 AME-së;
- 1x1 MAPL-së;
- 1x1 Dosjes.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assembly

Në mbështetje të nenit 11 neni 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), neni 52 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 53 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, neni 3 paragrafi 2, neni 4 dhe 5 neni 6 paragrafi 4 neni 12 paragrafi 1, i Udhëzimit Administrativ Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, ndërlidhur me nenin 13 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 i Rregullores (MAPL) Nr.02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunave, duke u bazuar në rekomandimin e MAPL-së Nr.020-10/18, të datës 13.02.2026, dhe neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), i Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës ne mbledhjen e rregullt te mbajtur me datën; 07.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

(Për rishqyrtimin e Vendimit Nr. 01-020/01-0008208/26 i datës; 03.02.2026, për formimin e komitetit për politik dhe financa)

Neni 1

Miratohet propozim-vendimi Nr. 01-020/01-0011515/26, i datës, 31.03.2026, Për rishqyrtimin e Vendimit Nr. 01-020/01-0008208/26 i datës; 03.02.2026, përkitazi me procedurën e formimit të komitetit për politik dhe financa.

Neni 2

Anëtari i Komitetit për Politikë dhe Financa **z.Dardan Shala**, nga subjekti politik (PDK), **Zëvendësohet** me anëtarën **znj. Arlinda Haliti**, nga i njëjti subjekt Politik (PDK) duke plotësuar përfaqësimin gjinor, bazuar në rekomandimin e MAPL-së Nr.020-10/12, të datës; 27.03.2026.

Neni 2

Mandati i anëtares të zëvendësuar është i njëjtë me mandat te Kuvendit te Komunës.

Neni 3

Neni 1 pika 4 i vendimit bazë Nr. 01-020.01-0000460/26 i datës; 05.01.2026, ndryshohet plotësohet, ndërsa pjesa tjetër mbetet ne fuqi dhe të pa ndryshuara, si dhe vendimi Nr. 01-020/01-0008208/26, i datës; 03.03.2026, mbetet ne fuqi.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit te tij ne ueb – faqen të Komunës.

Vendimi i Dërgohet :


1x1 Anëtarëve të zëvendësuar,
1x1 MAPL-së,
1x1 Zyrës së Kryetarit,
1x1 Arkivit,
1x1 Dosjes.

KRYESUESJA E KUVENDIT
znj. Adelina Spahiu-Alija





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assambly

**RREGULLORE NR. 01/2026 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN
E RREGULLORES NR.01-110/01-0025382/22 PËR TAKSA, TARIFA,
NGARKESA DHE GJOBA, E PLOTËSUAR DHE NDRYSHUAR ME
RREGULLOREN PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA
NR. 01-110/01-0031372/25 - KOMUNA SKENDERAJ**

Skenderaj, Prill 2026

Në mbështetje të nenit 11 dhe 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja c), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 13 dhe 15 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L -108 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, nenin 14, paragrafi 1 dhe 2 shkronja c) neni 35 paragrafi 1 dhe 2 shkronja c) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e mbajtur më: 30.04.2026, miraton këtë:

RREGULLORE NR. 01/2026 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR.01-110/01-0025382/22 PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA, E PLOTËSUAR DHE NDRYSHUAR ME RREGULLOREN PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA NR. 01-110/01-0031372/25.

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregullore është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores Nr. 01-110/01-0025382/22, të datës 06.06.2022 Për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025, të Komunës së Skenderajt.

Neni 2

1. Në nenin 11 ndryshohen dhe plotësohen paragrafët 11.5, 11.6 dhe 11.7, të cilët formulohen si në vijim:

Neni 11

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

11.5 Tarifat në Stacionin e Autobusëve:

Çmimet për secilën hyrje në Stacionin e Autobusëve përcaktohen në bazë të relacioneve të autobusëve.

11.6 Autobusët e relacionit ndër-urban:

- Autobusët e relacionit Skenderaj – Prishtinë **3.5 €;**
- Autobusët e relacionit Skenderaj – Mitrovicë **2.5 €;**
- Autobusët e relacionit Skenderaj – Klinë **2 €;**
- Autobusët e relacionit Skenderaj – Drenas **2 €.**

11.7 Autobusët e relacionit urban dhe urban-periferik 2 €.

2. Në neni 11 hiqen paragrafët 11.8 dhe 11.9.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi tridhjetë (30) pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe brenda shtatë (7) ditësh pas publikimit në web-faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

KRYESUESJA E KUVENDIT

Znj. Adelina Spahiu - Alija





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Bazuar në rekomandimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-177/14, të datës 03.04.2026, në mbështetje të nenit 11, nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe neni 40 par. 1 dhe 2 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, duke u bazuar në nenin 50, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 për Organizimin, Funksonimin dhe bashkëpunimin e Komunave me Fshatra, Vendbanime dhe Lagjet Urbane, dhe Rregullorja Nr.01-110/01-0047005/20 për Organizimin, Funksonimin dhe bashkëpunimin e Komunave me Fshatra, Vendbanime dhe Lagjet Urbane të Komunës së Skenderajt, dhe neni 14 par. 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 30.04.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

(Për rishqyrtimin e Vendimit për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës së Skenderajt për zgjedhjen e Këshillave Lokale)

Neni 1

Miratohet propozimi-vendim më Nr.02-020/01-0014192/26, i datës; 21.04.2026, për rishqyrtimin e Vendimit Nr. 01-020/01-0008203/26, të datës 27.02.2026, për themelimin e Komisionit të Kuvendit të Komunës për Zgjedhjen e Këshillave Lokale.

Neni 2

Plotësohet- Ndryshohet neni 2 i vendimit bazë Nr. 01-020/01-0008203/26, të datës 27.02.2026, në mënyrë që të respektohet barazia gjinore tek përbërja e Komisionit, në harmoni me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, për të siguruar kështu përfaqësim të barabartë gjinor në përbërjen e Komisionit të Kuvendit të Komunës për Zgjedhjen e Këshillave Lokale, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, Rregulloren Nr.01-110/01-0047005/20 për Organizimin, Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane të Komunës së Skenderajt dhe rekomandimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-177/14, të datës; 03.04.2026, zëvendësohen anëtarët si ne vijim;

- 1.z. Alban Berisha, zëvendësohet me znj. Adelina Spahiu – Alija, nga Legjislativi,
- 2.z. Afrim Kabashi, zëvendësohet me znj. Donika Mustafa, nga Legjislativi,
- 3.z. Milazim Mustafa, zëvendësohet me znj. Gentiana Zeqiri, nga Shoqëria civile.

Neni 3

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjnë : Anëtarët e Komisionit, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, plotësohet – ndryshohet vendimi bazë Nr. 01-020/01-0008203/26, të datës 27.02.2026, për themelimin e Komisionit të Kuvendit të Komunës për Zgjedhjen e Këshillave Lokale.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb – faqen të Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Arkivit,
- 1x1 Zyrës së Kryetarit .
- 1x1 Anëtarëve të komisionit,
- 1x1 MAPL-së,
- 1x1 Dosjes.

KRYEESUESJA E KUVENDIT

znj. Adelina Spahiu-EALIPA

